

R A P O R T
I
AUDITUSIT TË PAVARUR
PËR

FONDET E PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA
NGA PARTIA SOCIALISTE

NË FUSHATËN E ZGJEDHJEVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE ,
(8 MAJ 2011)

Drejtuar : - KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE
- PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Bazuar në Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të vendimit Nr.1232, datë 07.11.2011 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve si dhe në Kontratën e Shërbimit datë 16.11.2011 të lidhur me këtë institucion kryem auditimin e pasqyrave financiare, bashkelidhur, për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Socialiste gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, të zhvilluar më 8 Maj 2011.

Pergjegjësia e Drejtimit të Partisë Socialiste

Përgatitja e pasqyrave financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Socialiste gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore është përgjegjësi e drejtimit të saj.

Pergjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia e Audituesit është të shprehë një opinion mbi këto pasqyra, bazuar në auditimin e kryer në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit , në koherencë të plotë me SNA 800 (Mbi angazhimet e auditimit për qëllimet e veçanta). Këto standarte kërkojnë që auditimi të planifikohet dhe të kryhet për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve e dokumenteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në Pasqyrat Financiare të deklaruara. Ai përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve kontabile të ndjekura, vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlersimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës së fondeve të arkëtuara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore.

Ne çmojmë se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin tonë mbi Pasqyrat Financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Socialiste gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, të zhvilluar më 8 Maj 2011.

Opinion:

Bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Socialiste gjatë fushatës zgjedhore të organeve të qeverisjes vendore, zhvilluar më datën 8 Maj 2011, japin një pamje të vërtetë e të sinqertë .

Tiranë, më 14.01.2012

Ahmet STOJNA

Ekspert Kontabël i Regjistruar
Nr. 6 i Regjistrimit Publik të IEKA-s

Adresa: Rruga e Elbasanit, P."Radovani" Nr.5/5 Tirane
Tel 2468748 Mob 0684040661
E-mail : ahmetstojna@yahoo.com

**SHËNIME
TË
AUDITUESIT TË PAVARUR
MBI
DEKLARIMET FINANCIARE TË PARTISË SOCIALISTE
PËR
FUSHATËN E ZGJEDHJEVE TË ORGANEVE VENDORE
8 MAJ 2011**

Megjithëse fushata e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore ka filluar më 8 Prill 2011 dhe perfundoi më 8 Maj 2011, aktiviteti financiar në shërbim të kësaj fushate shtrihet në një periudhë më të gjatë se sa ky kufi zyrtar. Për Partinë Socialiste periudha financiare e fushatës zgjedhore shtrihet kryesisht në muajt Mars–Prill 2011, por vazhdon deri ne Gusht 2011 duke mospërfunduar as në këtë muaj pasi priten ngjarje të mëvonëshme për sigurimin e të ardhurave të tjera për të paguar shumën të konsiderueshme faturash të pranuar për shërbime të kryera nga disa media në shërbim të fushatës elektorale të Partisë Socialiste, por mbetur pa ulikujtuar për shkak se përbëjnë shpenzime të kryera mbi të ardhurat e realizuara.

Bazuar në auditimin e kryer, rezulton se të ardhurat janë evidentuar e deklaruar në bazë të arkëtimeve faktike, pa përfshirë arkëtimet e pritëshme, duke zbatuar rregullisht parimin kontabël të Kujdesit, ndërkohë që shpenzimet janë evidentuar e deklaruar në përputhje me parimin kontabel të angazhimeve sipas të cilit, ato përfshijnë të gjitha shpenzimet e kryera dhe të njohura pavarësisht në se janë paguar apo mbeten për t'u paguar në periudha të mëvonëshme. Bazuar në keto parime të kontabilitetit, në llogaritë kontabile e në Pasqyrat financiare të Partisë Socialiste janë evidentuar e deklaruar si shpenzime për fushatën zgjedhore edhe faturat e pranuar por të papaguara ndaj furnitorëve të ndryshëm për shërbimet e përfituara gjatë fushatës elektorale. Kjo menyrë veprimi është në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të dala në zbatim të tij.

- 2 -

Në këtë kuadër konceptual të të ardhurave e shpenzimeve , auditimi u shtri dhe mori në kosideratë edhe ngjarje e fakte ekonomike e financiare që i takojne fushatës zgjedhore të 8 Majit 2011, pavarësisht se ato kanë ndodhur edhe në periudha jashtë kufirit zyrtar të kësaj fushate.

Auditimi i situatës financiare të fushatës zgjedhore të Partisë Socialiste mori për bazë raportet financiare, regjistrat kontabile si dhe të gjithë dikumentacionin e nevojshëm i cili na bëri të mundur krijimin e bazes së opinionit të Audituesit të Pavarur për angazhime auditimi për qëllime të veçanta, në përputhje me SNA 800 , siç spjegohet në vijim.

a.- PËR TË ARDHURAT

Bazuar në auditimin e kryer rezulton se të ardhurat për fushatën elektorale të Partisë Socialiste ,sipas burimit të financimit të tyre, klasifikohen si vijon :

Nr	Burimi i financimit të të ardhurave	Shumat ne leke		
		Sipas Raportit Financiar	Sipas auditimit	Diferenca
1	Nga buxheti i shtetit	30,547,726	30,547,726	0
2	Nga fondet e vetë Partise Socialiste	74,468,380	74,468,380	0
3	Nga Donatoret (sponsorizime)			0
	- me banke	3,900,000	3,900,000	0
	- me arke	0	0	0
	- ne natyre	0	0	0
	Gjithsej te ardhura	108,916,106	108,916,106	0

Nga auditimi rezultoi se **Të ardhurat** e siguruar nga Partia socialiste për të përballuar fushatën e zgjedhjeve të organeve te qerverisjes vendore janë deklaruar gjithsej 108.916.106 lekë. Këto të ardhura janë krijuar nga tre burime të ligjeshme, dhe konkretisht:

1.- Financime nga buxheti i shtetit për fushatën elektorale 30.547.726 lekë ose 28.05 për qind e totalit të fondeve të përdorura për fushatën e zgjedhjeve të organeve vendore, zhvilluar më 8 Maj 2011. Këto para janë arkëtuar më datën 29.04.2011, në llogarinë nr.11000602 T, në Bankën Kombëtare Tregtare, të çelur posaçërisht nga Partisë Socialiste për këtë fushatë zgjedhore.

1.- Fondet e vetë Partisë Socialiste 74.468.380 lekë, të cilat përbëjnë pjesën kryesore të burimeve të financimit të fushatës elektorale, duke zënë 68.37 për qind të të ardhurave gjithsej. Nga kontrolli i fluksit të parasë rezulton se Partia Socialiste në fillim të vitit 2011 ka trashëguar në llogaritë bankare të saj 29.525.263 lekë, nga të cilat më 30.03.2011 kanë mbetur pa u shpenzuar 6.726.680 lekë. Gjithashtu, krahas të ardhurave të tjera nga veprimtaria e Partisë Socialiste, më datën 06.04.2011, nëpërmjet llogarive bankare të saj, janë akorduar nga buxheti i shtetit sipas planit të financimit vjetor të partive politike edhe 80.677.253 lekë, (shkresa nr.1664/1, datë 29.03.2011 e KQZ-së) Një pjesë e këtyre fondeve, në shumën 74.468.380 lekë është evidentuar dhe deklaruar si e ardhur për të përballuar shpenzimet e fushatës elektorale për zgjedhjet e 8 Majit 2011, prandaj ky fond u përfshi në objektin tonë të auditimit.

3.- Donacionet nga shtetas shqiptarë të ndryshëm, për shumën totale 3.900.000 lekë përbëjnë burimin e tretë të krijimit të fondeve për fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste, duke zënë 3.58 për qind e fondeve gjithsej të siguruar për fushatën zgjedhore. Janë gjithsej 12 dhurues fondesh, shtetas shqiptarë të cilët kanë sponsorizuar me shumën parash mbi 100.000 lekë për çdo rast për fushatën elektorale të zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore si vijon:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Shuma ne leke	Data e dhurimit	Llogaria ku jane derdhur parate
1	Arjan Ahmetaj	800,000	28.04.2011	Nr.288405 KREDINS
2	Gramoz Ruçi	300,000	28.04.2011	Nr.288405 KREDINS

- 4 -

3	Damjan Gjikhuri	300,000	28.04.2011	Nr.288405 KREDINS
4	Taulant Balla	300,000	28.04.2011	Nr.288405 KREDINS
5	Ervin Koçi	300,000	28.04.2011	Nr.288405 KREDINS
6	Pirro Lutaj	200,000	28.04.2011	Nr.288405 KREDINS
7	Arben Çuko	400,000	29.04.2011	Nr.288405 KREDINS
8	Fatmir Xhafa	200,000	29.04.2011	Nr.288405 KREDINS
9	Artan Gaci	200,000	29.04.2011	Nr.288405 KREDINS
10	Besnik Bare	200,000	29.04.2011	Nr.288405 KREDINS
11	Eurudin Dokle	400,000	29.04.2011	Nr.288405 KREDINS
12	Xhemal Qefalija	300,000	29.04.2011	Nr.288405 KREDINS
	Shuma	3,900,000	x	X

Nga verifikimi rezultoi se të gjithë dhuruesit kanë nënshkruar deklaratën e mospasjes konflikt interesi në përputhje me nenin 89 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Te gjithë këta dhurues janë evidentuar dhe deklaruar ne regjistrin e posaçëm , të mbajtur sipas formatit të miratuar me vendimin nr.266, datë 01.06.2009 nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Në të gjitha rastet dhuruesit kanë respektuar kërkesën ligjore të Kodit Zgjedhor sipas të cilës dhurata nuk mund të jetë më shumë se 1.000.000 lekë për çdo rast. Po ashtu, nga verifikimi rezultoi se të gjitha këto dhurime janë kryer nëpërmjet llogarisë bankare nr. 288 405, llogari e posaçme e çelur për fushatën elektorale te 8 Majit 2011 nga Partia Socialiste pranë Bankës CREDINS si dhe janë deklaruar brënda afatit ligjor.

Partia Socialiste nuk ka deklaruar raste sponsorizimesh në shuma më pak se 100.000 lekë për çdo rast, sidhe sponsorizime në para nga persona juridikë vendas a të huaj apo sponsorizime ne natyre nga ndonjë subjekt juridik apo person fizik dhe **as nga verifikimet tona nuk rezultuan të tilla.**

b.- PËR SHPENZIMET

Nga verifikimet e kryera rezultoi se shpenzimet për fushatën elektorale të Partisë Socialiste, te grupuara sipas natyres se tyre jane si vijon :

Nr	Grupet e shpenzimeve	Shumat ne leke		
		Sipas Raportit Financiar	Sipas auditimit	Diferenca
a	Shpenzime të paguara			0
1	Reklama e spote televizive	84,579,443	84,579,443	0
2	Reklama në radio			0
3	Parrulla e tabela, printime	7,971,083	7,971,083	0
4	Flamuj dhe bluza	999,840	999,840	0
5	Karburant	1,021,000	1,021,000	0
6	Qira ambjentesh	1,980,800	1,980,800	0
7	Konsulencë	998,000	998,000	0
8	Minikaseta	400,830	400,830	0
9	Kanceleri, letër, fotokopje	647,720	647,720	0
10	Foltore	0	840,000	-840,000
11	Foni, vidio projektore, muzukë etj	0	7,892,544	-7,892,544
12	Kërkesë padë	360,000	360,000	0
13	Të ndryshme	9,957,390	1,224,846	8,732,544
	Shuma e shpenzimeve të paguara	108,916,106	108,916,106	0
b	Shpenzime të papaguara			0
1	Reklama televizive	27,582,159	27,582,159	0
	Shuma e shpenzimeve të papaguara	27,582,159	27,582,159	0
	Gjithsej Shpenzime (a+b)	136,498,265	136,498,265	0

Shpenzimet e fushatës së Partisë Socialiste për zgjedhjet e 8 Majit 2011 janë deklaruar gjithsej 136,498,265 lekë, nga të cilat deri në datën e hartimit të këtij Raporti janë paguar 108,916,106 lekë dhe diferenca 27,582,159 lekë, ndonëse është njohur si shpenzim , nuk rezulton që të jetë paguar brenda kësaj periudhe.

- 6 -

Nga verifikimet tona rezulton se këto shpenzime nuk e kalojnë kufirin ligjor të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Koha e kryerjes se shpenzimeve në përgjithësi përputhet me afatin zyrtar të fushatës zgjedhore, por një pjesë e tyre janë bërë para fillimit zyrtar të fushatës dhe një pjesë tjetër pas datës 8 Maj 2011, në varësi nga koha e pranimit apo likuidimit të faturave për shërbimet e përfituara. Deklarimi i shpenzimeve është bërë në mënyrë korrekte.

Shpenzimet që, për shkak të mungesës së fondeve financiare, kanë mbetur pa u paguar përbëhen nga detyrime ndaj disa mediave të cilat kanë kryer shërbime reklamash gjatë fushatës zgjedhore. Këto shërbime të gjitha janë të dokumentuara dhe të vërtetuara me fatura tatimore me tvsh, e konkretisht :

Nr	Fatura		Subjekti	shuma leke
	Numër	Datë		
1	136	05.05.2011	Ora SHA	7,901,971
2	1	05.05.2011	Channal One (pjesore)	1,424,600
3	190	05.05.2011	NEËS 24	1,210,910
4	192	05.05.2011	NEËS 24	1,209,465
5	170	06.05.2011	Media Vizion SHA	2,419,400
6	171	06.05.2011	Media Vizion SHA	514,600
7	172	07.05.2011	Media Vizion SHA	548,700
8	173	07.05.2011	Media Vizion SHA	1,745,200
9	83	09.08.2011	Top Albania	224,313
10	3461	04.05.2011	Top-Channal	9,629,820
11	3484	07.05.2011	Top-Channal	470,000
12	667	17.06.2011	SCAN SHA	283,180
	Shuma			27,582,159

Në tërësi shpenzimet janë të dokumentuara me fatura tatimore apo mandat arkëtime të institucioneve buxhetore që nuk janë subjekte tatimore si dhe janë të evidentuara në pajtim me rregullat dhe standartet kontabile që zbatohen në Shqipëri.

- 7 -

Pë të krijuar një opinion më të drejtë, krahas grupimit të deklaruar nga Partia Socialiste, ne i riklasifikuam shpenzimet për fushatën e zgjedhjeve sipas natyrës së tyre, në 9 grupe shpenzimesh.

Ndryshimet në grupeve të veçanta të shpenzimeve janë pa efekte materiale në tërësinë e tyre dhe përfundimisht totali i shpenzimeve sipas auditimit është i barabartë me atë që ka deklaruar Partia Socialiste. Shpenzimet të klasifikuara nga ana jonë janë si vijon :

1. Shpenzimet për Reklama televizive, radio e gazeta 112.161.602 lekë zëne pjesën kryesore ose 82.17 për qind të tyre. Nga këto, 84.579.443 lekë janë likujduar ndërsa diferenca 27.582.159 lekë ka mbetur pa u paguar për mungesë fondesh duke u evidentuar e deklaruar në Kontabilitetin e Partise si Detyrime të Kërkueshme nga Furnitorët që do të shlyhen kur të sigurohen burime financimi.

Te detajuara sipas subjekteve mediatike këto shpenzime përbëhen nga shërbime të kryera prej :

Nr.	Emërtimi	Shuma lekë
1	Top Channal sha	46,450,805
2	Media Vizion sha	19,037,756
3	NEWS 24	21,119,287
4	Chanal One	3,460,353
5	Top Albania Radio	660,342
6	Ora sha	19,240,571
7	SCAN sha	283,180
8	Gazeta Telegraf	72,100
9	Gazeta Shqiptare	448,000
10	Gazeta Shekulli	324,000
11	Gazeta Shqip	240,000
12	Dixhitalb	825,208
	TOTALI	111,161,602

Këto shpenzime janë kryer në bazë të kontratave të lidhura midis palëve dhe vërtetohen me fatura te rregullta tatimore. Nga verifikimi rezultoi se të gjitha faturat

e likujduara që i përkasin këtij grupi shpenzimesh janë paguar vetëm nëpërmjet llogarive bankare.

2.- Shpenzimet për materiale publicitare 8.970.923 lekë zënë 6.57 per qind të atyre gjithsej. Në këtë grup shpenzimesh janë deklaruar ato për banera, printime, flamuj, spote e hapësira të ndryshme publicitare të përdorura gjatë fushatës zgjedhore, duke i deklaruar në dy grupe kryesore,

- City lights, tabela 7.971.083 lekë, dhe
- Flamuj e bluza 999.840 “

Nga verifikimi rezultoi se këto shpenzime vërtetohen me fatura tatimore dhe janë paguar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare 8.470.923 lekë dhe Bankës CREDINS 500.000 lekë.

3.-Shpenzimet për foni, muzikë e 7.892.544 leke dhe **shpenzimet për foltore** 840.000 leke, gjithsej 8.732.544 lekë në Pasqyrën Financiare të PS janë deklaruar në grupin e **Shpenzimeve të ndryshme**, por në gjykimin tim paraqesim në grup më vehte për shkak të peshës së konsiderueshme që zënë kundrejt totalit të shpenzimeve, 6,4 per qind. Siç e shpjegojmë edhe në paragrafët para ardhës, rigrupimi i këtyre shpenzimeve nuk sjell asnjë efekt material negativ në opinionin e adituesit mbasi edhe këto shpenzime janë të vërtetuara me dokumente të rregullta dhe janë pasqyruar e deklaruar në tërësinë të shpenzimeve të fushatës. Pagesa e tyre është bërë nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare 8.232.544 lekë dhe CREDINS 500.000 lekë.

4.- Shpenzimet për karburant 1.021.000 leke janë të dokumentuara me fatura blerje tatimore të lëshuara nga “EUROPETROL DURRËS ALBANIA” sha. Pagesa e tyre është bërë nëpërmjet llogarive bankare.

5.- Shpenzimet për konsulence 998.000 leke, konvertuar në 10.000 USD (sipas kursit bankar në ditën e likuidimit) i janë paguar këshilltarëve amerikanë sipas Kontratës datë 26.03.2011 nëpërmjet llogarisë së Partisë në Bankën Kombëtare Tregtare.

- 9 -

6.- Shpenzimet për qira salle 1980.800 leke nga verifikimi rezultoi se edhe këto shpenzime vërtetohen me dokumente me siguri të arsyeshme dhe janë likuiduar kryesisht nëpërmjet llogarive bankare.

7.- Shpenzimet për kanceleri 647.720 lekë dhe për **minikaseta** 400.830 lekë, përbëhen kryesisht nga shpenzime për letër, bojë printeri, fotokopje, të cilat janë paguar nëpërmjet arkës. Nga verifikimi rezultoi se ato përgjithësisht janë të dokumentuara me fatura të rregullta tatimore.

8.- Shpenzimet për kerkesë padi 360.000 leke janë vërtetuar me Mandat Arketimet e lëshuara nga Gjykata e Apelit për të njëjtën shume.

9.-Shpenzimeve të Ndryshme 1,224,846 lekë ku përfshihen shpenzime për hapjen e mbylljen e fushatës, shpenzime interneti etj, të cilat ,nga verifikimi rezultoi se edhe këto shpenzime janë të dokumentuara , janë paguar kryesisht nëpërmjet llogarive bankare ose karta krediti për ato që janë kryer jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë. Deklarimi i tyre, me siguri të arsyeshme, është i besueshëm.

Perfundimisht, bazuar në auditimin e kryer, sipas Standartit Ndërkombëtar të Auditimit nr.800 (për qëllime të veçanta) me siguri të arsyeshme, në Raportin e Audituesit të Pavarur kemi shprehur opinionin se Pasqyra Financiare e Te Ardhurave dhe Shpenzimeve të fushatës elektorale të Partisë Socialiste jep një pamje të vërtetë e të sigurtë të të ardhurave të realizuara e të shpenzimeve të kryera gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të 8 Majit 2011.

Tiranë, më 15 Janar 2012

Ahmet STOJNA

Ekspert Kontabël i Regjistruar
Nr. 6 i Regjistrimit Publik të IEKA-s

Adresa: Rruga e Elbasanit, P."Radovani" Nr.5/5 Tirane
Tel 2468748 Mob 0684040661
E-mail : ahmetstojna@yahoo.com